



МАКЕДОНСКИ  
ЦЕНТАР ЗА  
МЕЃУНАРОДНА  
СОРАБОТКА

**QËNDRIMI  
NDAJ  
VLERAVE  
TRADICIONALE  
/SEKULARE/**

Shkup, maj 2009



МАКЕДОНСКИ  
ЦЕНТАР ЗА  
МЕЃУНАРОДНА  
СОРАБОТКА

# QËNDRIMI NDAJ VLERAVE TRADICIONALE/SEKULARE

*Shkup, maj 2009*

**Botues**

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar

**Për botuesin**

Sasho Klekovski, Drejtor i parë ekzekutiv

**Autor**

Sasho Klekovski

**Përktheu**

Ermira Kuçlar

Mendimet që janë shprehur këtu i takojnë autorit dhe nuk i reflektojnë qëndrimet e Qendrës Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Copyright © 2009 Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS), Shkup. Të gjitha të drejtat janë ruajtur.

## PËRMBAJTJA

<b>HYRJE .....</b>	<b>4</b>
<b>Konteksti .....</b>	<b>4</b>
<b>Termet dhe definicionet.....</b>	<b>4</b>
<b>Metodologjia dhe qasja.....</b>	<b>4</b>
<b>QËNDRIMI NDAJ VLERAVE TRADICIONALE / SEKULARE.....</b>	<b>6</b>
<b>Përfundime.....</b>	<b>9</b>
<b>Bibliografi.....</b>	<b>10</b>

## HYRJE

### KONTEKSTI

Në këtë raport janë analizuar rezultatet nga anketa **“Qëndrimi ndaj vlerave tradicionale / sekulare”**.

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS) ia besoi anketën e mendimit publik, mbi të cilin bazohet ky raport, Institutit për Hulumtime Sociologjike dhe Politiko-Juridike (IHSPJ), përgjegjësia e të cilit ishte edhe metodologjia e drejt e anketës.

### TERMET DHE DEFINICIONET

Në matjen e fushave kryesore të interesimit të njeriut, nga religjioni deri te politika, deri te ekonomia dhe jeta sociale, dy dimensione dominojnë me pasqyrën: vlera tradicionale / sekulare ose racionale dhe vlerat për ekzistencë / vetë – reflektimi (Ingelhart, 1997, 2000)

Dimensioni i vlerave tradicionale / sekulare – racionale e reflekton kontrastin mes shoqërive ku religjioni është shumë i rëndësishëm dhe në atë ku ai nuk është i rëndësishëm. Rang i gjerë i pyetjeve të tjera janë të lidhura ngushtë me këtë dimension. Shoqëritë e afërta me shoqëritë tradicionale e theksojnë rëndësinë e raporteve prind – fëmijë, respekt (dëgjueshmëri) ndaj autoritetit, bashkë me standardet absolute dhe vlera tradicionale familjare, dhe e refuzojnë shkurorëzimin, abortin, eutanazinë dhe vetëvrasjen. Këto shoqëri kanë nivel të lartë të krenarisë nacionale dhe vështrimit nacionalist. Shoqëritë me vlera sekulare – racionale kanë zgjidhje të kundërta në raport me të gjitha këto pika.

Konzervatizmi social është ideologji politike ose morale e cila beson se qeveria ka rol në nxitjen ose zbatimin e vlerave dhe qëndrimeve tradicionale, të bazuara në besimin se kjo i ruan njerëzit të civilizuar dhe me dinjitet. Por rëndësia e pranuar e moralit tradicional dallohet nga shoqëria në shoqëri. Prandaj nuk ka politika dhe pozita universale mes personave konservativ social. Si do që të jetë ka numër të caktuar të parimeve ndaj të cilave qëndrojnë konservativët social: janë për pozitën për pro-jetën në pyetjet për abortin, janë kundër hulumtimit të qelizave amë, e mbështetin dënimin me vdekje, i kundërshtojnë martesat mes seksit të njëjtë dhe të drejtën e tyre për birësim të fëmijëve, promovojnë moral publik dhe vlera tradicionale familjare, e kundërshtojnë sekularizmin dhe privaten e fesë, e mbështetin ndalesën e drogës, punën seksuale (prostitucionit) dhe eutanazinë, e mbështetin censurën e pornografisë etj. Edhe krahas ekzistimit të parimeve të konservatizmit social ilustrimi i dallimeve nga njëra në shoqërinë tjetër është mos arsyetimi i homoseksualitetit, që në kontekst të caktuar do të thotë mospranimi i martesave të seksit të njëjtë, ndërsa në kontekst tjetër do të thotë homoseksualiteti është vepër kriminele (penale).

Në këtë hulumtim përdoret termi prostitucion, i cili llogaritet si diskriminues, si sqarim i termit puna seksuale.

### METODOLOGJIA DHE QASJA

Hulumtimi është realizuar mes anketës gojore në mars të vitit 2009 në ekzemplar reprezentues prej 1.600 të anketuarve.

## Pyetëtori

Pyetjet janë dhënë si pjesë e hulumtimit global Civikus – Indeksi i shoqërisë civile, ndërsa i plotësuar dhe adaptuar nga autori dhe nga ekipi i projektit të MCMS, në bashkëpunim me ekspertë nga IHSPJ. Me pyetëtorin u përfshinë këto variabile:

- Shkalla e arsyeshmërisë së shkurorëzimit, abortit, eutanazisë, homoseksualitetit, vetëvrasjes, punës seksuale (prostitucioni) dhe dhuna familjare
- Karakteristika socio-demografike

## Ekzemplari

Anketa u realizua në mars të vitit 2009 në ekzemplar reprezentues prej 1.600 të anketuarve. Korniza e popullatës të ekzemplarit ishte më e vjetër se 18 vjet, ndërsa kriteret për reprezentativën ishin: gjinia, përkatësia etnike, mosha, vendi i banimit dhe rajoni. Gjithashtu kishte kujdes gjatë zgjedhjes së anketuarve dhe sipas kriterëve tjera siç është arsimimi, përkatësia religjioze etj.

Prej 1.600 të anketuarve, 49,6% ishin femra, ndërsa 50,4% meshkuj, lidhur me përfaqësimin etnik 63,8% të anketuarve ishin maqedonas, ndërsa 24,1% shqiptarë, derisa grupet tjera etnike ishin përfaqësuar me 12,1%. Lidhur me vendin e banimit, popullata rurale ishte e përfaqësuar me 41,2%, derisa ajo e qytetit me 58,8% (qyteti i Shkupit me 21,3%).

## Përpunimi dhe prezantimi i rezultateve

Të dhënat e grumbulluara janë përpunuar me shpeshti dhe proporcion të përgjigjeve. Të dhënat janë me besueshmëri të saktë prej 95% dhe me gabim (nivel i rëndësisë) +/-5%. Rezultatet janë shprehur në grafik në nivel të gjithë ekzemplarit. Krahas grafikeve të dhënat janë shprehur edhe me numra.

Në këtë raport pakicë e parëndësishme është përdorur për përgjigje më të vogla se 10% nga ekzemplari, pakicë e vogël për 11% deri 30%, pakicë për 30% deri 50%, shumicë për 51% deri 70% dhe shumicë e madhe për më shumë se 70%.

## Grupi punues


MCMS i inkuadroi disa nga bashkëpunëtorët e vet në të gjitha fazat e hulumtimit: Sasho Klekovski, Aleksandar Kërzhhalovski, Gonce Jakovleska, Suçica Sazdovska, Daniela Stojanova dhe Miodrag Koliq.

Nga ekipi i IHSPJ u inkuadruan Klime Babunski, Aneta Jovevska, Petar Atanasov dhe Emilia Simovska.

## QËNDRIMI NDAJ VLERAVE TRADICIONALE / SEKULARE


Hulumtimi për qëndrimin ndaj vlerave tradicionale / sekulare – racionale, përfshin pyetjet, si shkurorëzimi, aborti, eutanazia dhe homoseksualiteti. Janë përfshirë edhe pyetjet për dhunën familjare, si dhe pyetje të tjera. Për të kuptuar kontekstin në vend është përfshirë pyetja për të qenë religjioz të qytetarëve.

**Grafiku 1. Arsyeshmëri**



Qytetarët më së shumti e arsyetojnë divorcin (41,1 %) dhe abortin (35,1 %), ndërsa më pak vetëvrasjen (2,4 %).

**Grafiku 2. Arsyeshmëri**



Burri që e rreh gruan nuk e arsyetojnë 96,9 % të qytetarëve, ndërsa të rriturit që i rrahin fëmijët nuk e arsyetojnë 93,1 % të qytetarëve.

Dallimet e seksit për çështje të rëndësishme gjinore janë relativisht të vogla.

**Tabela 1. Krahasimi i qëndrimeve të meshkujve dhe femrat për çështjet e rëndësishme gjinore**

	Mehskujt/ nuk është e arsyeshme	Femrat / nuk është e arsyeshme
Divorci	60,5 %	57,4 %
Aborti	67,3 %	62,4 %
Puna seksuale (Prostitucioni)	89,8 %	95,1 %
Homoseksualiteti	92,3 %	90,8 %
Burri ta rreh gruan	94,9 %	99 %

Dallimet etnike mes maqedonasve etnike dhe shqiptarëve etnik de mes qytetarëve të besimit të krishterë dhe të besimit mysliman paraqiten te të gjitha qëndrimet, ndërsa te disa qëndrime ato janë të dukshme.

**Tabela 2. Krahasimi i qëndrimeve të maqedonasve etnike dhe të shqiptarëve etnik**

	Maqedonasit / nuk është e arsyeshme	Shqiptarët / nuk është e arsyeshme
Divorci	53,5 %	72,5 %
Aborti	59,0 %	79,8 %
Homoseksualiteti	90,1 %	94,8 %
Burri ta rreh gruan	98,6 %	91,5 %
Të rriturit ti rrahin fëmijët	97,3 %	80,1 %

Dallime në qëndrime mes maqedonasve etnik dhe shqiptarëve etnike, si dhe mes qytetarëve të besimit të krishterë dhe besimit mysliman, mund të sqarohen me shkallën e ndryshme të jesh religjioz. Për lidhshmërinë shih tabelën më poshtë 3 dhe 6.

Të jesh religjioz ndikon në qëndrime të caktuara. Qytetarët të cilët janë religjioz dhe të cilët nuk janë religjioz kanë shumë qëndrime të ngjashme vetëm në çështjet e vetëvrasjes dhe punën seksuale (prostitucioni). Qytetarët të cilët janë religjioz më pak e arsyetojnë divorcin, abortin, homoseksualitetin, eutanazinë. Qytetarët të cilët nuk janë religjioz më pak e arsyetojnë dhunën familjare.

**Tabela 3. Krahasimi i qëndrimeve të qytetarëve religjioz dhe joreligjioz**

	Religjioz / nuk është e arsyeshme	Joreligjioz / nuk është e arsyeshme
Divorci	61,9 %	41,8 %
Aborti	69,9 %	48,9 %
Homoseksualiteti	93,8 %	78,9 %
Eutanazia	79,3 %	60,8 %
Puna seksuale (Prostitucioni)	93,1 %	90,3 %
Vetëvrasja	98,2 %	95,8 %
Burri ta rreh gruan	91,9 %	97,5 %
Të rriturit ti rrahin fëmijët	92,9 %	94,5 %

Vendi i banimit gjithashtu ndikon në qëndrimet, me përjashtim të vetëvrasjes dhe dhunës familjare, ku nuk ka dallime të dukshme në qëndrimet. Qytetarët e Shkupit kanë miratim më të madh për divorcin, abortin dhe homoseksualitetin.

**Tabela 4. Krahasimi i qëndrimeve të qytetarëve nga rajonet rurale dhe qyteti i Shkupit**



	Rurale / nuk është e arsyeshme	Shkupi / nuk është e arsyeshme
Divorci	63,3 %	46,2 %
Aborti	71,3 %	50,3 %
Homoseksualiteti	97 %	78,9 %
Eutanazia	80,1 %	64,1 %
Puna seksuale (Prostitucioni)	93,9 %	87,4 %


Përkundër pritjeve, nuk ekziston dallim i madh në bazë partiake (ideologjike) mes të djathtës dhe të majtës, gjegjësisht mes simpatizuesve të VMRO-DPMNE dhe LSDM.

**Tabela 5. Krahasimi i qëndrimeve të simpatizuesve të VMRO-DPMNE dhe LSDM**

	VMRO-DPMNE / Nuk është e arsyeshme	LSDM / Nuk është e arsyeshme
Divorci	63,2 %	57,6 %
Aborti	66,1 %	59,4 %
Homoseksualiteti	95,2 %	88 %
Eutanazia	79,6 %	66,4 %
Puna seksuale (Prostitucioni)	94,1 %	92,2 %
Burri ta rreh gruan	98,7 %	99,5 %
Të rriturit ti rrahin fëmijët	97,0 %	98,2 %

Edhe pse deklarohen si pjesëtarë të një religjioni të caktuar, qytetarët të cilët mendojnë se janë religjioz janë 83,3%, të cilët nuk janë religjioz 14,8%. Për ateistë janë deklaruar 1,1%, ndërsa pa përgjigje 0,8%.

**Grafiku 2. A mendoni se jeni**



Disa nga karakteristikat lidhur me shkallën e të qenurit religjioz janë cekur në tabelën më poshtë.

**Tabela 6. Profili i më shumë apo më pak të qenurit qytetar religjioz**

	Më shumë religjioz	Më pak religjioz
Mosha	18-29 v. (85,7 %)	Mbi 65 v. (72,3 %)
Përkatësia etnike	Shqiptarët etnik (92,2 %)	Maqedonas etnik (81,2 %)
Feja	Myslimanë (90,4 %)	Të krishterë ortodoks (81,3 %)
Arsimimi	Arsimim fillor të papërfunduar (93,1 %)	Arsimim sipëror (75,7 %)
Të ardhurat mujore	Më të ulëta (95,5 %)	Më të larta (82,5 %)
Vendi i banimit	Rurale (90,1 %)	Shkup (67,1 %)

Përkundër pritjeve, përsëri nuk ekziston dallim i dukshëm në bazë partiake (ideologjike) mes të djathtës dhe të majtës, gjegjësisht mes simpatizuesve të VMRO-DPMNE dhe LSDM, prej të cilëve janë religjioz 84,9%, gjegjësisht 79,2%.

## PËRFUNDIME

### 1. Maqedonia është mjedis tradicional ose social konzervativ

Maqedonia në kuptimin social ose shoqëror është relativisht mjedis konzervativ. Mbështetja e vlerave tradicionale, gjegjësisht joarsyeshmëria është prej 58,9%, për shkurorëzimin deri 91,6% për homoseksualitetin.

Kjo është vërtetuar edhe me Pasqyrën e vlerave botërore, gjegjësisht në Maqedoni janë forcuar vlerat tradicionale. Indeksi nacional për vlerat tradicionale / sekulare për Maqedoninë është zvogëluar prej 0,31 në vitin 1995 në 0,12 në vitin 2000 (për vitin 2006 nuk ka të dhëna). Sipas Inglehart – Velzel harta kulturore e botës, vlera më të fuqishme tradicionale nga Maqedonia në rajon kanë Bosnja dhe Hercegovina dhe Rumania, derisa të tjerat kanë vlera më të fuqishme sekulare (duke përfshirë Shqipërinë, Bullgarinë dhe Serbinë). Në Evropë vlera më të fuqishme tradicionale ka në Poloni.

### 2. Është e pranishme dhuna familjare dhe e gjeneratave

Edhe pse ka pakicë të vogël të qytetarëve të cilët e arsyetojnë dhunën mbi gruan (3,1%) dhe fëmijët (6,9%), numri i qytetarëve të cilët këtë e arsyetojnë kërkojnë vëmendje më të madhe ndaj këtyre çështjeve. Vëmendje kërkon edhe arsyeshmëria relativisht e lartë e dhunës mbi fëmijët prej 19,9% të shqiptarët etnik.

### 3. Meshkujt dhe femrat me qëndrime të ngjashme për çështjet gjinore

Qëndrimet e meshkujve dhe femrave për çështjet gjinore, duke përfshirë edhe abortin, janë të ngjashme dhe nuk dallohen për më shumë se +/-5 poenë të përqindjes, me përjashtim të punës seksuale (prostitucionit).

### 4. Dallimet mes maqedonasve etnik dhe shqiptarëve etnik

Ekzistojnë dallime mes maqedonasve etnik dhe shqiptarëve etnik, të cilat përsëriten mes të krishterëve ortodoks dhe myslimanëve.

Mbështetja e vlerave tradicionale është prej 53,5% për joarsyeshmërinë e shkurorëzimit deri 90,1% për joarsyeshmërinë e homoseksualitetit të maqedonasit etnik, në krahasim me 72,% deri 94,8% të shqiptarët etnik. Dallimi më i madh është te pyetja e abortit (joarsyeshmëria është për 20,8 poenë të përqindjes më e lartë se sa të shqiptarët etnik), ndërsa më e vogël te çështja e homoseksualitetit (dallimi është 4,7 poenë të përqindjes).

Dallimet etnike me siguri lidhen me ndikimin e të qenurit religjioz në qëndrimet dhe me të qenurit religjioz të ndryshëm të maqedonasve etnik dhe shqiptarëve etnik.

### 5. Dallime për çështje të caktuara dhe qëndrime të ngjashme për çështje tjera mes qytetarëve religjioz dhe joreligjioz

Qytetarët religjioz i mbështetin vlerat tradicionale, në krahasim me qytetarët joreligjioz. Për shembull, joarsyeshmëria e shkurorëzimit të qytetarët religjioz është më e lartë për 20,1 poenë të përqindjes. Krahas këtyre qëndrimeve, edhe të dy grupet kanë qëndrime të ngjashme për çështjet tjera, për shembull, në jomiratimin e punës seksuale (protistucionit).

### 6. Në Shkup mbështetja më e madhe për çështjet për vlerat sekulare

Mbështetja për vlerat sekulare është më e madhe në Shkup. Nga ana tjetër mbështetja më e vogël është në rajonet rurale. Për shembull, joarsyeshmëria e shkurorëzimit të qytetarët e Shkupit është për 17,1 poenë të përqindjes më e vogël se nga qytetarët në rajonet rurale.

### **7. Nuk ekziston dallim i madh partiak (ideologjik)**

Nuk ekziston dallim i madh në bazë partiake (ideologjike) mes të djathtës dhe të majtës, gjegjësisht mes simpatizuesve të VMRO-DPMNE dhe LSDM.

Mes simpatizuesve të VMRO-DPMNE joarsyeshmëria e abortit është 66,1%, ndërsa mes simpatizuesve të LSDM, kjo është 59,4%. Dallim më të madh ka vetëm për çështjen e eutanazisë.

Edhe te çështja e të qenurit religjioz nuk ekziston dallim i madh mes simpatizuesve të VMRO-DPMNE dhe të LSDM, prej të cilëve religjioz janë 84,9%, gjegjësisht 79,2%.

### **8. Religjiozitet i lartë i qytetarëve**

Shumicë e madhe e qytetarëve, gjegjësisht 83,3% mendojnë se janë religjioz, për joreligjioz llogariten 14,8%, ndërsa 1,1% janë ateistë.

## **BIBLIOGRAFI**

Inglehart R. (1977) **The Silent Revolution**. Princeton University Press.

Inglehart R., Baker W. (2000) **Modernization, Cultural Change and the Persistence of Traditional Values**. American Sociological Review.

Inglehart R. (2007) **National-level Value scores by country**. Available from web: [http://margaux.grandvinum.se/SebTest/wvs/articles/folder\\_published/article\\_base\\_111](http://margaux.grandvinum.se/SebTest/wvs/articles/folder_published/article_base_111) [Accessed Date 20/05/2009]